

COVID-19 | Maatregelen | 01/10/2020

Albanees | Vertaald uit het Nederlands

## Masat që merren nga 1 tetori

### Hyrje

Qeveria ka vënë rregulla për të ndaluar koronavirusin. Respektoji rregullat! Kështu ti nuk sëmuresh, apo nuk mund të sëmuresh asnjëri. Policia mund të të kontrollojë.

Vini re: Disa qytete/bashki dhe komuna kanë rregulla shtesë. Shiko faqen e internetit të qytetit/bashkisë apo të komunës.

### 6 rregulla shumë të rëndësishme

- Bëj kujdes me higjenën tënde! Rri në shtëpi nëse je i/e sëmurë! Laji shpesh duart e tua me ujë dhe sapun!
- Mbaj minimumi 1,5 metra distancë nga personat e tjerë!
- Bëj kujdes edhe më tepër tek pacientët e rrezikueshëm :
  - njerëzit më të moshuar se 65 vjeç,
  - njerëzit me probleme të zemrës, mushkërive apo veshkave,
  - njerëzit që infektohen lehtësisht.
- Është mira t'a lësh të takohesh me të tjerë përjashta.
- Nëse bën ndonjë gjë (aktivitet) me një grup, atëherë lejohet të mbidheni bashkë me maksimumi 10 persona.
- Kufizo personat me të cilët ke kontakte të afërt deri në maksimumi 5 persona. Nuk është e nevojshme të mbash 1,5 metra distancë me personat me të cilët ke kontakt të afërt.

### Të shkosh në një qytet apo shtet tjetër

- Në Belgjikë :
  - Lejohet të udhëtosh kudo.
  - Nëse ti përdor transportin publik (autobus, tramvaj apo tren) dhe nëse ti ke moshë më të madhe se 12vjeç, atëherë ti duhet mbash një maskë për gojë ose një shall mbi gojën dhe hundën tënde. Kjo është e detyrueshme.
- Me pushime jashtë shtetit :
  - Lejohet të udhëtosh për në shtetet e tjerë. Janë 3 lloje zonash.
    - ▶ Lejohet të udhëtosh për në zonat e gjelbra/jeshile. Kjo gjë është e sigurtë (pa rrezik).
    - ▶ Është mira të mos udhëtosh për në zonat e kuqe apo portokalle.

- Shiko në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme: [diplomatie.belgium.be](https://diplomatie.belgium.be). Çdo shtet mund të ketë rregulla të tjerë. Kontrollloji rregullat në [https://diplomatie.belgium.be/nl/Diensten/Op\\_reis\\_in\\_het\\_buitenland/reisadviezen](https://diplomatie.belgium.be/nl/Diensten/Op_reis_in_het_buitenland/reisadviezen)
- Ti duhet të plotësosh një formular para se të kthehesh në Belgjikë. Këtë formular mund t'a giesh në: <https://travel.info-coronavirus.be/nl/public-health-passenger-locator-form>.
- Nëse ishe në një zone të kuqe për më gjatë se 48 orë atëherë këto 3 gjëra duhet t'i bësh pa dyshim kur kthehesh në Belgjikë:
  - 1 Është e detyrueshme të rrish në karantinë.
  - 2 Ti duhet të plotësosh një formular në <https://travel.info-coronavirus.be/nl/public-health-passenger-locator-form>. Ty të jepet një kod për një test nëse ke rrezik të madh që je infektuar me koronavirus.
  - 3 Ti duhet të rrish në shtëpi për minimumi 7 ditë. Dil përjashta vetëm nëse duhet me do e mos!. Për shembull: për të shkuar tek farmacia, mjeku apo në supermarket. Në atë rast mbaj gjithmonë një maskë për gojë!
  - 4 -
- Nëse ke qënë në një zonë portokalli për më gjatë se 48 orë, atëherë këto 3 gjëra duhet t'i bësh pa dyshim kur kthehesh në Belgjikë:
  - 1 Është mira të rrish në karantinë.
  - 2 Ti duhet të plotësosh një formular në <https://travel.info-coronavirus.be/nl/public-health-passenger-locator-form>. Ty të jepet një kod për një test nëse ke rrezik të madh që je infektuar me koronavirus.
  - 3 Është mira që të rrish në shtëpi për minimumi 7 ditë. Dil përjashta vetëm nëse duhet me do e mos!. Për shembull: për të shkuar tek farmacia, mjeku apo në supermarket. Në atë rast mbaj gjithmonë një maskë për gojë!

## Punë

- Puno nga shtëpia, nëse është e mundur!
- Nëse ti duhet të shkosh në punën tënde për të punuar, atëherë shefi (punëdhënësi) duhet të kujdeset, që të ketë distancë prej 1,5 metra ndërmjet personave! Nëse kjo nuk mund të bëhet, atëherë kërkoji shefit tënd një maskë për gojë.
- Nëse ke pyetje, merr informacione nga shefi yt.

## Dyqanet

- Të gjithë dyqanet janë hapur. Ka tregje (tregjet hapur).
- Vendos një maskë për gojë në dyqane dhe në treg! Kjo është e detyrueshme.
- Dyqani i natës është hapur deri në ora 22 të mbrëmjes.
- Ti duhet të mbash një maskë për gojë. Kjo është e detyrueshme.
- Ka tregje (tregjet lejohen).
- Ti mund të shkosh tek berberi/floktorja apo tek salloni i bukurisë.
  - Merr një takim!
  - Mbaj/vendos një maskë për gojë!

### Hotel restaurant kafe

- Kafetë dhe restorantet janë hapur deri në ora 1 të natës.
  - Është mira që të rrezervosh më përpara.
  - Lejohet të shkosh në restorant apo kafe vetëm me familjen tënde (apo personat me të cilët bashkëjeton) dhe 5 personat e pandryshueshëm të kontaktit tuaj.
  - Rri ulur në tavolinë!
  - Ti duhet të mbash një maskë për gojë. Kjo është e detyrueshme. Nëse je ulur në tavolinë, atëherë nuk është nevoja të mbash një maskë për gojë.
  - Ti duhet të japësh të dhënat e tua të kontaktit.

### Kontakt social

- Lejohet të takohesh me kë të dëshirosh. Mbjaj gjithmonë 1,5 metra distancë ose vër një maskë për gojë!
- Lejohet të kesh kontakte të afërt me maksimumi 5 të njëjtët persona. Në këtë rast 1,5 metra distancë nuk është e nevojshme. Fëmijët nën 12 vjeç nuk llogariten këtu.
- Nëse bën ndonjë gjë (aktivitet) me një grup, atëherë lejohet të mbidheni bashkë me maksimumi 10 persona. Fëmijët nën 12 vjeç nuk llogariten këtu.

### Lëvizje / aktivitet fizik

- Nëse je në një klub sporti, atëherë lejohet të bësh sport me maksimumi 50 persona.
- Lejohet të bësh sport në një qendër fitnesi, klub sportiv, apo në pishinë.
- Lejohet që të shkosh në një sauna apo në qendër wellness-i.

### Koha e lirë

- Gjithçka është hapur, për shembull, një bibliotekë, një park lojrash (tematik) apo një sallë të lojrave apo kazino.
- Nëse shkon në një aktivitet të organizuar zyrtarisht (për shembull festë e fshatit, ndeshje sportive apo në një shfaqje kulturore, atëherë ka një maksimum numri të pranishëmve.
  - maksimumi 200 persona brenda, maksimumi 400 persona përjashta
  - Çdo organizatë ka rregulla të veçanta. Lexo/kontrollo faqen në internet.
- Nëse ti vetë organizon një festë apo një mbledhje, atëherë lejohet të jenë maksimumi 10 persona.
- Ti duhet të mbash një maskë për gojë. Kjo është e detyrueshme në këta vende:
  - dyqane dhe qendra tregtare
  - rrugë me shumë dyqane
  - vende me shumë njerëz
  - ndërtesa publike
  - tregje
  - transport publik
  - biblioteka,
  - kinema,

- muze,
- në sallat e teatrit, koncertit, konferencash
- auditorë
- festa e pazare lokale me lojra
- ndërtesa fetare.
- Ti duhet të japësh të dhënat e tua të kontaktit nëse shkon në:
  - qendrat wellness
  - mësimet sporti në një klub
  - pishina
  - kazino
  - salla feste dhe pritjeje

### Çfarë nuk lejohet akoma?

- Diskotekat dhe klubet e natës nuk lejohet akoma të hapen.
- Festivalët nuk lejohen.

### Besim fetar

- Shërbimet fetare lejohen të bëhen.
  - Lejohet të jenë maksimumi 200 persona.
  - Nuk lejohet kontakti fizik.
  - Ti duhet të mbash një maskë për gojë! Kjo është e detyrueshme.

### Çerdhe dhe shkolla

- Çerdhet janë hapur.
- Të gjithë nxënësit mund të shkojnë në shkollë. Shkolla jote të jep informacione të mëtejshëm për vitin e ri shkollor.

### Inkurajim / nxitje

Këta rregulla janë të rëndësishëm për shëndetin e gjithësecilit. Gjithësecili duhet t'i rrespektojë ata.

Faleminderit që do të bësh këtë gjë! Së bashku, ne e ndalojmë koronavirusin.